



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA

Emërtimi i Modulit: PËRKTHIM TEKNIK NË FUSHËN E SË DREJTËS PENALE

(KSHK 7, Kualifikim për të nxënit gjatë gjithë jetës 3, Programet e studimeve të formimit të vazhduar)

Programi i Formimit të Vazhduar : “PËRKTHIM TEKNIK, LETRAR DHE INTERPRETIM”

Lloji i Trajnimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime: “Gjuha e burimit” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip.

“Gjuha e synuar” anglisht, frëngjisht, italisht, të huajisht, greqisht, spanjisht, turqisht, rusisht, shqip

Kohëzgjatja e programit të modulit: 30 orë

Mënyra e zhvillimit: Trajnim i drejtpërdrejtë në prezencë / online

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Programi përmban trajtimin e temave që lidhen me përkthimin në fushën e së Drejtës Penale nga gjuha e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas. Në trajnim do të trajtohen tekste me terminologji nga fusha e së drejtës penale. Pjesëmarrësit do marrin një vështrim të përgjithshëm mbi bazat e së drejtës penale duke arritur të dallojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet në të dy gjuhët e punës. Ata do jenë në gjendje të kuptojnë tiparet e një vepre penale, anën subjektive dhe objektive të saj, autorët dhe përcaktimin e tyre në faza të ndryshme të ndjekjes, hetimit dhe gjyqimit penal, proporcionalitetin e dënimit dhe ekzekutimin e tij etj., si dhe do përvetësojnë terminologjinë përkatëse përmes ushtrimeve dhe përkthimeve konkrete, në fushën e së drejtës penale, si të akt-akuzave, vendimeve të gjykatës etj.

Moduli synon t’u japë përfituesve njohuri teorike dhe praktike nga fusha e së drejtës penale dhe t’i aftësojë ata në gjetjen e zgjidhjeve në rastet problematike të mungesës së barasvlerësve krijuar jo vetëm për shkaqe gjuhësore, por edhe prej ndryshimeve që çdo e drejtë sjell me vete.

OBJEKTIVAT E MODULIT:

Ky modul synon:

- të japë njohuri bazë krahasuese mbi të drejtën penale shqiptare dhe të vendeve të huaja;
- të ofrojë njohuritë e duhura mbi nivelet e ndryshme të zbërthimit të teksteve nga e drejta penale;
- të ndihmojë në ngritjen e një fjalori bazë me terma të së drejtës penale;
- të prezantojë dhe ofrojë teknika dhe modele përkthimi në fushën e së drejtës penale;
- të aftësojë të interesuarit në përkthimin në fushën e së drejtës penale